

FEDERATA E KARATESË E KOSOVËS
KOSOVA KARATE FEDERATION



Rregullore për shpërblime dhe mirënjohje nga FKK

Prishtinë, 2021

I. Dispozita e përgjithshme

Qëllimi:

Neni 1.

Me këtë rregullore, rregullohen rregullat dhe procedurat për ndarjen e mirënjohjeve për të gjithë ata që me punën e tyre, kontributin e tyre dhe aktivitetin e tyre ndikuan në zhvillimin dhe avancimin e karatesë në Kosovë.

Neni 2.

Çmimi i nderimit me mirënjohje nga Federata e Karatesë së Kosovës ,është nderimi më i lartë që Federata do të ndajë për:

- sportist aktivë,
- trajner aktiv
- zyrtar aktiv
- zyrtarë dhe personalitete sportive e politike, që kanë dhënë kontribute të jashtëzakonshme në zhvillimin, promovimin dhe përhapjen e karatesë.
- zyrtarë dhe personalitete sportive e politike, që kanë dhënë kontribute të jashtëzakonshme në zhvillimin, promovimin dhe përhapjen e karatesë - Postmortum.

Metoda e zbatimit:

Neni 3.

- Mirënjohjet e nderimit nga FKK do të jepen në garat/ngjarjet zyrtare të FKK -së.
 - Në ditën e themelimit të FKK-së,
 - Në ditën e përzgjedhjes së sportistit të vitit apo shpalosjes së rezultateve të FKK-së.

Neni 4. Përzgjedhja për mirënjohje,nderim dhe gradim posmortum,bëhet nga Komisioni për përzgjedhje në FKK,në bashkëpunim me Komisionin për grada dhe bordin e FKK-së.

Çmimet e mirënjohjeve:

Neni 5.

- Medalje bronzi për:
 - Zyrtarët ose anëtarët në bordin e Federatës së Karatesë së Kosovës që kanë shërbyer mbi 2 mandate

- Zyrtarët sportiv, trajnerët, referët që kanë bërë punë të denjë për FKK-në për më shumë se 10 vjet.
- Garues cili ka shkëlqyer në disa turne ndërkombëtarë gjatë vitit të kaluar.
- Medalje argjendi për:
 - Zyrtarët sportiv, trajnerët ,referët që kanë bërë punë të denjë për FKK-në për më shumë se 20 vjet.
 - Garues që arriti vendin e parë, dytë apo të tretë në kampionatin Evropian ose në gara të nivelit të njejtë gjatë vitit të kaluar.
- Medalje ari për:
 - Zyrtarët sportiv, trajnerët ,referët që kanë bërë punë të denjë për FKK-në për më shumë se 30 vjet.
 - Garues që fitoi medaljen e artë në Kampionatin Evropian, apo një medalje bronzi, argjendi apo ari në Kampionatin Botëror, ose fitoi renditjen e përgjithshme të Premier League për vitin e kaluar.
- Distinktiv të FKK-së për:
 - Zyrtarët sportiv, trajnerët që kanë bërë punë të denjë për FKK-në për më shumë se 40 vjet.
 - mund t'u jepet personave që i kanë kryer shërbime të vazhdueshme avancimit të FKK_së (sponsorë, politikanë, gazetarë, ...).

Katana për:

- Zyrtarët sportiv dhe trajnerët për “ vepër jetësore” me FKK-në.

President nderi/Anëtar nderi për:

- Bordi i Federatës së Karatesë së Kosovës mund emëroj anëtar nderi, anëtarët e bordit, zyrtarët, trajnerët që në bazë të meritave të jashtëzakonshme për kontributin e tyre , pavarësisht a janë apo nuk janë akoma aktiv në ato funksione.
- Bordi i FKK-së mund të nderojë një president si president nderi, atë që e ka përfunduar mandatin e tij, në nderim dhe njohje të arritjeve të tij të jashtëzakonshme.
- Bordi i FKK-së mund të nderoj, zyrtarët, trajnerët, referët, e punëtorët administrativ me mirënjohje nderi për vepër jetësore.
- Bordi i FKK-së mund të nderoj, zyrtarët, trajnerët, referët, e punëtorët administrativ me mirënjohje nderi post mortum.

Brezi i nderit për:

Njerëzve meritorë që kontribuan për FKK-në, e që nuk praktikojn karate, por kontribojn në zhvillimin dhe avancimin e sportit të karateesë.

Brezat nga 6-9 DAN mund të ju jepet karatekave aktive për merita të jashtëzakonshme mbi moshën 60 vjeç.

Gradim posmortum:

Gradim simbolik posmortum për një shkallë (DAN) më lartë se sa shkalla (DAN-i) që posedonte si trajner në FKK sa ishte ndër të gjallët.

II. Dispozita e përfundimtare

Neni 6.

- Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të obligueshme për komisionin për përzgjedhje të FKK -së.

Neni 7.

Interpretimin e kësaj Rregulloreje e bënë Bordi Drejtues i FKK-së.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje kryhen në mënyrë dhe procedurë të njejtë të përshkruar për miratimin e saj.

Neni 8.


Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje pushon të vlejë Rregullorja e deritashme.

Neni 9.

Kjo Rregullore hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të kryetarit të FKK-së

Në Prishtinë, me 19 qershor 2021

Ismet Krasniqi



Kryetari i FKK-së